286/20
30.06.20

PSH .nr.286/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068,dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: "Samire Osmani B.I. & D.P.T. "Jonatan -P"- Suharekë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar OE NSHB "ZONA PARK" – Prizren lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Spërkatja nga toka e zonave endemike nga ethet hemorragjike" me nr. të prok: 62500-20-927-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Malishevë, më datë: 26.06.2020, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Samire Osmani B.I. & D.P.T. "Jonatan -P"- Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Spërkatja nga toka e zonave endemike nga ethet hemorragjike" me nr. të prok: 62500-20-927-2-2-1, të iniciuar nga AK- Kuvendi Komunal Malishevë.

II.ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Spërkatja nga toka e zonave endemike nga ethet hemorragjike" me nr. të prok: 62500-20-927-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Malishevë, dhe lënda kthehet ne **rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV .Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "Samire Osmani B.I. & D.P.T. "Jonatan -P"- Suharekë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues "Samire Osmani B.I. & D.P.T. "Jonatan -P"- Suharekë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 08.05.2020 me nr. 286/ 20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Spërkatja nga toka e zonave endemike nga ethet hemorragjike" me nr. të prok: 62500-20-927-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Malishevë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 56 dhe 59 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 18.05.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 28.05.2020, lidhur me pretendimin ankimorë të OE-ankues sqaron si në vijim:

Eksperti shqyrtues konstaton se në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit është kërkuar: "Operatori Ekonomik duhet të paraqes listën e shërbimeve të njëjta të realizuara në tri vitet e shkuara, nga data e publikimit të njoftimit për kontratë", te dëshmitë dokumentare është kërkuar: "Të dorëzoni listën e shërbimeve të realizuara në tri vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontrate e vërtetuar nga ju, ku përfshihen tituj e projekteve, numri, datat e kontraktimit dhe përfundimit të tyre si dhe dëshmitë e përfundimit certifikatat (raportet e pranimit), referencat për shërbimet etj. Nëse kontrata është e lidhur me persona fizik, dëshmia e pagesës përmes bankës)".
Opertatori ekonomik ankues në dosjen e tenderit ka ofruar kontrata dhe referenca (DDD) siç shihen edhe në listën më poshtë, mirëpo mendoj kontratat dhe referencat e prezantuar nuk janë të njejta me titullin e aktivitetit të prokurimit: "Spërkatja nga toka e zonave endemike nga ethet hemorragjike".

" Samire Osmani " B.I.

LISTA E PROJEKTEVE TE REALIZUARA NGA
" Samire Osmani " B.I. NGA VITI 2018

Nr	Emri I Projektit	Nr. Prokurimit dhe Nr. i Brendshëm	Data e Nënshkrimit të Kontratës	Vendi	Data e Perfundimit projektit, Data e Faturës	Vlera Totale e projektit
1	Shërbimet e Dezinfektimit Deratizimit dhe Dezinfektimi	70010-18-1607-2-2-1	10.05.2018	Spitali I Përgjithshëm Prizren	05.02.2019	12,862.00
2	Dezinfektimi, Dezinfektimi dhe Deratizimi I qytetit të Prizrenit	622-18-014-221	24.09.2018	Komuna e Prizrenit	28.01.2019	13,244.00
3	Deratizimi Dezinfektimi Dezinsektimi i Objektave te Brendshme Spitalore	70040-18-1649-2-1-6	07.05.2018	Spitali I Përgjithshëm Mitrovicë	05.06.2018	1,950.00
4	Dezinfektimi Dezinsektimi dhe Deratizimi e objektave te shkollave te Hamushës	626/17/045/236	21.12.2017	Komuna e Hamushës	15.02.2018	750.00
5	Dezinfektimi Dezinsektimi dhe Deratizimi e objektave te shkollave te Hamushës	626-18-029-247	11.08.2018	Komuna e Hamushës	05.10.2018	994.50
	Kompania Kosovare për Disttribuimin dhe Furnizim me Energji Elektrike SHA.	380/04	25.04.2018	Prishtinë	12.05.2018	5,775.98
	Kontratë Kornizë per Sherbime Dezinfektimi, Deratizimit dhe Dezinsektimit (DDD) për KEDS SH.A	416/06	02.08.2018	Prishtinë	14.12.2018	1,632.40
	Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike SHA Kontrajtë për DDD	379/04	25.04.2018	Prishtinë	12.06.2018	743.40
	Kërkesë e Shërbimeve të DDD-së me objekte te ciat jane me perberje te dhënavemë te veçantë	16-1-2017	16.01.2017	Fushë Gjakovë Kosovë	02.02.2018	455.00
	Shërbimet e Dezinfektimi Deratizimit dhe Dezinsektimit	12-12-2018	12.12.2018	Tregu Qendër Prishtinë	24.01.2019	5,156.63
	Shërbimet e Dezinfektimi Deratizimit dhe Dezinsektimit në tërë Rajonin - N.T.P. I.BK	16-1-2018	16.01.2018	N.T.P. I.BK Prizren	16.01.2019	1,750.00
	Kompania Kosovare për Disttribuimin, Furnizim me Energji Elektrike SH.A. Kontrat për DDD	380/04-1	25.04.2019	Prishtinë	15.05.2019	7,557.14
	Kontratë Kornizë per Sherbime e DDD-se për KEDS sh.a	380/04-1	25.04.2019	Prishtinë	15.05.2019	743.40
	TOTALI					54,816.47

Drejtor:

S. Osmani

Samire Osmani

BIZNES INDIVIDUAL SAMIRE OSMANI B.I. Lëshuar SUHAREKË

Eksperti shqyrtues konstaton se në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit është kërkuar: "OE të ketë ekspertin për lëminë e spërkatjes së sipërfaqeve kundër rriqrave–një agronom, epidemiolog ose biolog i diplomuar në cilësi te ekspertit", te dëshmitë dokumentare është kërkuar: "Për ekspertin të sillet diploma ose certifikata kopje, CV-ja e tij dhe kontrata e punës".

Operatori ekonomik në dosjen e tenderit e ka ofruar Listën e stafit: Ku në këtë listë tek numri rendor 7. e ka deklaruar z.Kadri Cikaqi, të punësuar si agronom për këtë projekt.

OE ankues për z. Cikaqi, si dëshmi në dosje e tenderit i ka ofruar Listën e stafit, CV-në, Kontratë dhe Diplomën, në listën e stafit shënon se i njëjti do të filloj punën menjëherë me fillimin e projektit, CV nuk ka asnjë përshkrim të përvojës së punës. Në kontratën e lidhur me dt:04.06.2020, në mes të Samire Osmani me NUI 81104427, Nr. TVSH 330354621 dhe z. Kadri Cikaqi, shënon Kontrata është valide nga data e nënshkrimit, për angazhimin z. Arsim Gashi do të paguhet në vlerë 170 €, duke i bërë 140 orë pune në javë.

Si sqarime shtesë, OE ankues "Samire Osmani B.I. & D.P.T. "Jonatan -P"- Suharekë, ia ka ofruar AK-së edhe

një përgjigje dhe CV-in në lidhje me z. Muhamet Qadraku, e që i njëjti është në listën e stafit, ku në dosje të tenderit ishin të bashkangjitura Diploma dhe Kontrata (mungonte CV-ja).

Eksperti shqyrtues sqaron se nuk qëndron arsyeja e eliminimit të AK-së, ku AK-ja e eliminon OE ankues "Samire Osmani B.I. & D.P.T. "Jonatan -P"- Suharekë, me arsyetimin: "Produkti juaj nuk është preparat sipas kërkesave të BE, ashtu siç është kërkuar nga ana jonë tek Pjesa II, është kërkuar që produkti të ka origjinë nga vendet e BE-së", sepse në dosjen e tenderit në rubrikën e tetë (8) është kërkuar vendi i origjinës, nuk është cekuar se a duhet të jetë nga BE apo ndonjë vend tjetër.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues "Samire Osmani B.I. & D.P.T. "Jonatan -P"- Suharekë, të aprovohet pjesërisht e bazuar, dhe të mbetet në fuqi njoftimi për dhënie të kontratës në lidhje me aktivitetin e prokurimit "Spërkatja nga toka e zonave endemike nga ethet hemorragjike" me nr. të prok: 62500-20-927-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Malishevë.

Autoriteti Kontraktues, më datë 29.05.2020 me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik ankues , më datë 03.06.2020 me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 26.06.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Lidhur me pikën e eliminimit te OE ankues te dhen nga ana e AK-së , se i njëjti OE nuk ka ofruar Referenca ashtu siç janë kërkuar në dosjen e tenderit Referenca për Shërbime të natyrës së njëjtë –Spërkatje nga toka e zonave endemike nga ethet hemoragjike .

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit është kërkuar: "Operatori Ekonomik duhet të paraqes listën e shërbimeve të njëjta të realizuara në tri vitet e shkuara, nga data e publikimit të njoftimit për kontratë", te dëshmitë dokumentare është kërkuar: "Të dorëzoni listën e shërbimeve të realizuara në tri vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontrate e vërtetuar nga ju, ku përfshihen tituj e projekteve, numri, datat e kontraktimit dhe përfundimit të tyre si dhe dëshmitë e përfundimit certifikatat (raportet e pranimit), referencat për shërbimet etj. Nëse kontrata është e lidhur me persona fizik, dëshmia e pagesës përmes bankës)".

Paneli shqyrtues konstaton se Opertatori ekonomik ankues në dosjen e tenderit ka ofruar kontrata dhe referenca (DDD) siç shihen edhe në listën e ofruar nga OE ankues, te gjitha kontratat dhe referencat kane te bejne me kryerjen e sherbimeve te kesaj lemie por vetm se ne tituj nuk shenon sperkatje, pra e tere natyra e ktyre sherbimeve eshte sperkatje, pra nuk mund te elimonohet nje Operator ekonomik qe veprimtari primare e ka sherbimet e DDD, gjithashtu siç shihet nga kontratat dhe referencat thuaj se veprimtari te vetme gjithashtu shihet se eshte i specializuar me kete veprimtari, sepse tek e fundit edhe vet natyra e ketij aktiviteti te prokurimit eshte DDD, pra eshte sperkatje te insekteve, dallimi eshte se ne referenca nuk permendet fjala sperkatije siç permendet ne titull te ketij aktiviteti te prokurimit, paneli shqyrtues vie ne perfunsdim se ky pretendim ankimor eshte i bazuar.

Lidhur me arsyen tjetër të eliminimit të OE ankues nga ana e AK-së, se te njëjtit OE i mungojnë dëshmitë për ekspertin për lëminë e spërkatjes së sipërfaqeve kundër rriqrave–një agronom, epidemiolog ose biolog.

Paneli shqyrtues sqaron se në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit është kërkuar: "OE të ketë ekspertin për lëminë e spërkatjes së sipërfaqeve kundër rriqrave–një agronom, epidemiolog ose biolog i diplomuar në cilësi te ekspertit", te dëshmitë dokumentare është kërkuar: "Për ekspertin të sillet diploma ose certifikata kopje, CV-ja e tij dhe kontrata e punës".

Operatori ekonomik në dosjen e tenderit e ka ofruar Listën e stafit: Ku në këtë listë tek numri rendor 7. e ka deklaruar z.Kadri Cikaqi, të punësuar si agronom për ketë projekt. Operatori ekonomik ankues për z. Cikaqi, si dëshmi në dosje e tenderit i ka ofruar Listën e stafit, CV-në, Kontratë dhe Diplomën, ku në listën e stafit shënon se i njëjti do të filloj punën me njëherë me fillimin e projektit, ndërsa CV-a e ekspertit në fjalë nuk ka asnjë përshkrim të përvojës së punës, Paneli shqyrtues sqaron se si sqarime shtesë, OE ankues "Samire Osmani B.I. & D.P.T. "Jonatan -P"- Suharekë, ia ka ofruar AK-së edhe një përgjigje dhe CV-in në lidhje me z. Muhamet Qadraku, e që i njëjti është në listën e stafit, ku në dosje të tenderit ishin të bashkangjitura Diploma

dhe Kontrata (mungonte CV-ja). AK nëse ka dilema lidhur me këtë çështje mund te kërkoj sqarime shtese konform nenit 59 dhe 72 te LPP-së.

Paneli shqyrtues konstaton se nuk qëndron arsyeja e eliminimit të AK-së, ku AK-ja e eliminon OE ankues "Samire Osmani B.I. & D.P.T. "Jonatan -P"- Suharekë, me arsyetimin: "Produkti juaj nuk është preparat sipas kërkesave të BE, ashtu siç është kërkuar nga ana jonë tek Pjesa II, është kërkuar që produkti të ka origjinë nga vendet e BE-së", është e pa qëndrueshme kjo arsyen e eliminimit te OE ankues për faktin se në dosjen e tenderit në rubrikën e tetë (8) është kërkuar vendi i origjinës, nuk është cekuar se a duhet të jetë nga BE apo ndonjë vend tjetër, andaj ky pretendim i OE ankues është i qëndrueshëm.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët. Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë. Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së. Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- "Kuvendi Komunal Malishevë",

1x1 OE - "Samire Osmani B.I & Jonatan – P" – Suharekë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.